

KOMENTE TË PËRGJITHSHME
Mbi raportin e monitorimit te Gjykatës Kushtetuese për vitin 2014

1. Karakteristikat kryesore të performancës.

Gjykata Kushtetuese për vitin 2014, administron dhe menaxhon fondet publike me një program të miratuar, që është:

▪ **Programi 03320, “Veprimtaria gjyqësore, kushtetuese”**

Për vitin 2014, situata në lidhje me realizimin e shpenzimeve të buxhetit, krahasuar me planin vjetor, paraqitet si më poshtë:

	% e realizimit, kundrejt buxhetit vjetor
▪ “Veprimtaria gjyqësore, kushtetuese”	95 %
Totali i institucionit	95 %

Nga një vështrim i përgjithshëm, duke gjykuar vetëm mbi realizimin në vlerë të shpenzimeve të planifikuara për vitin 2014, për programin e vetëm “Veprimtaria gjyqësore, kushtetuese”, i këtij institucioni, evidentohet nje performance e mire ne realizimin e shpenzimeve vjetore. Sipas zerave perberes te shpenzimeve, situata në fund të vitit 2014, paraqitet, e tillë:

	Shpenzime korrente	Shpenzime kapitale
▪ “Veprimtaria gjyqësore, kushtetuese”	97 %	100 %
Totali i institucionit	97 %	100 %

Në këtë realizim për shpenzimet korrente në fund të vitit 2014, ka një ecuri, të mirë, normale në përputhje me treguesit e buxhetit të miratuar. Ndikim ka patur mos shpenzimi sipas programit buxhetor per -6,132,157 leke, detajuar si me poshte:

- Fondit të pagave per -3,414,146 leke ose 95 %, per mosrealizim te politikës se rritjes se pagave, dhe te raportuara si fonde te lira ne fund te vitit.
- Fondit te sigurimeve shoqerore e shendetsore per -1,782,996 leke ose 82 %, per rrjedhoje te mosplotesimit te fondit te pagave dhe te raportuara si fonde te lira ne fund te vitit.
- Shpenzimeve operative per -935,015 leke ose 97 %, duke bere edhe nje riprogramim te tyre duke i vene fondet ne dispozicion per nevojat e tjera dhe fundvitit.

Nga fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për shpenzimet kapitale, deri në fund të vitit 2014, janë realizuar 18,272,600 leke lekë nga 18,287,000 leke te miratuara me buxhetin e

rishikuar sipas vendimeve të Keshillit të Ministrave dhe Aktit Normativ nr.2, date 29.12.2014.

Me këtë fond janë realizuar të gjitha objektivat dhe diferenca prej -14,400 lekë vjen nga kursimi i fondeve gjatë procesit të prokurimeve.

2. Performanca e produkteve kryesore

Në këtë program janë përfshirë 4 produkte, performanca e të cilëve në terma vlerore paraqitet e mirë në fund të vitit 2014.

Nuk raportohet në lidhje me realizimin e produkteve në terma sasiore të detajuar.

	% e realizimit kundrejt buxhetit vjetor		
	<u>Shpenzime korente</u>	<u>Shpenzime kapitale</u>	<u>Totali i shpenzimeve</u>
▪ Programi “Veprimtaria gjyqësore, kushtetuese”	94 %	100 %	95 %
Nga kjo:			
Produkti A	93 %		93 %
Produkti B			
Produkti C	98 %	100 %	99 %
Produkti D	95 %	99 %	95 %
Totali i institucionit	94 %	100 %	95 %

3. Krahasimi i të dhënave faktike, të raportit të institucionit me të dhënat e thesarit, për të njëjtën periudhë raportuese.

Ne milion leke

Programet	Shpenzimet korente			Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve		
	Institucioni.	Thesari	Dif.	Institucioni	Thesari	Dif.	Institucioni	Thesari	Dif.
Veprimtaria gjyqësore kushtetuese	103,933	103,933	0.0	18,272	18,272	0.0	122,205	122,205	0.0
Totali i institucionit	103,933	103,933	0.0	18,272	18,272	0.0	122,205	122,205	0.0

Ashtu siç shikohet edhe nga tabela e mësipërme, të dhënat e raportuara nga Gjykata Kushtetuese në tabelat e monitorimit të shpenzimeve për vitin 2014, përputhen plotësisht me të dhënat e nxjerra nga sistemi i thesarit.

4. Informacion mbi volumin dhe madhësinë e ndryshimit të buxhetit.

Për programin e këtij institucioni, situata në lidhje me ndryshimet në planifikim gjatë vitit 2014, përfshirë këtu buxhetin fillestar, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Ne mln leke

Programet	Buxheti fillestar 2014	Buxheti me ndryshime	Diferenca
Veprimtaria gjyqsore kushtetuese	114,000	123,852	+14,352
Totali i institucionit	114,000	123,852	+14,352

Diferenca prej **+14,352,000 lekë** është rezultat i ndryshimeve në buxhetin e vitit 2014, si me poshte:

- Shtesa e buxhetit me VKM nr.484, date 16.07.2014 +13,000,000 leke
Nga kjo:
÷Shtesa e shpenzimeve kapitale +13,000,000 leke
- Shtesa e buxhetit me VKM nr.766, date 12.11.2014 +2,000,000 leke
Nga kjo:
÷Shtesa e shpenzimeve kapitale +2,000,000 leke
- Pakesimi i buxhetit me aktin normative nr.2, date 29.12.2014 -713,000 leke
Nga kjo:
÷Pakesimi i shpenzimeve kapitale(kursim nga tenderat) -713,000 leke
- Shtesa e buxhetit nga perdorimi i fondit te veçante +65,000 leke
- Ndryshime te brendshme midis zerave perberes te buxhetit 0 leke
Nga kjo:
÷Pakesimi i shpenzimeve per transferta me jashte(605) -356,800 leke
÷Shtesa e shpenzimeve operative(602) +356,800 leke

5. Komente të tjera

Në lidhje me realizimin e produkteve në terma sasiorë të detajuar, gjëndja në fund të vitit 2014, paraqitet, e tillë:

	% e realizimit, kundrejt buxhetit vjetor
Produkti "A", Vendimarrja e gjykates	137 %
Produkti "B", Informatizimi i veprimtarise gjyqsore	
Produkti "C", Automjete te mirembajtura	100 %
Produkti "D", Punonjes te motivuar	100 %
Totali i institucionit	122 %

Diferencat midis performancës së produkteve në terma vlerore me ato në terma sasiorë(99 % me 122 %) vjen nga ndikimi i tejkalimit të numrit të të parashikuar të vendimeve gjyqsore e ne veçanti atyre te kolegeve.